



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Mbledhja nr. 03

Prishtinë, më 28 mars 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Nënkomision për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Behar Selimi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Živković.

Mungoi: Mufera Šinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE, Shefki Kastrati – NDI, Jerina Damper – OSBE, Artan Canhasi – EULEX, Natyra Kosumi – NDI, Tafil Rrahmani – A.P. , Isa Hasani A.P., Fixhrije Dragaj dhe Alban Krasniqi – praktikant.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion - Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.3.2011;
3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, nr. 04-P-005/k, përkitazi me hartimin e rregullave procedurale për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij;
4. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë lidhur me kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore;
5. Formimi i Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21. 3. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 21.3.2011.

3. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë së Kuvendit, nr. 04-P-005/k, përkitazi me hartimin e rregullave procedurale për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

Kryetari theksoi se në mbledhjen e kaluar është kërkuar që në mbledhjen e radhës të vendoset se cili komision duhet t'i hartojë rregullat, Komisioni për Legjislacion ose për të Drejtat e Njeriut, pasi kishte dilema. Lidhur me këtë e hapi diskutimin.

Armend Zemaj- Ripërsëriti qëndrimin e tij që Komisioni për Legjislacion është kompetent për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit, ndërsa sa i përket arsyetushmerisë unë kam thënë se është kategori kushtetuese, edhe ashtu, si komision, e ka këtë kompetencë, jo vetëm për interpretim, por edhe për zgjedhjen e kësaj kategorie, sepse edhe për nga rëndësia, por edhe për nga hartimi i procedurave bie në fushëveprimtarinë e këtij komisioni. Fushëveprimtaria e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, me rregullore thuhet se vetëm bashkëpunon me Avokatin e Popullit në fushën e të drejtave të njeriut. Në vazhdim tha se tash po shihet edhe nevoja për interpretim, e këtë e bën komisioni për mandate, rregullore dhe imunitete, si nënkomision.

Arsim Bajrami – Kërkoj sqarim nga administrata e Komisionit se si është e paraparë me rregullore kjo çështje.

Lidhur me këtë, administrata sqaroi se kjo çështje bie në fushëveprimin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Kryetari sqaroi se rregullorja, sa i përket Avokatit të Popullit, e ka vetëm një pikë, ku thuhet se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, “ bashkëpunon me Avokatin e Popullit”, nuk flet për kompetenca të tjera, ndërsa as ligji nuk e precizon se cili komision është kompetent. Andaj lidhur me këtë duhet të mendojmë se a duhet të marrim si përgjegjësi hartimin e rregullave?

Ibrahim Makolli - Në fjalën e tij tha se as ligji, e as rregullorja e Kuvendit nuk e qartësojnë kompetencën lidhur me këtë çështje. Ai shtoi se nuk do të ishte keq që kryetari i Komisionit për Legjislacion bashkë me kryetarin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, të takohen dhe të shikohet mundësia se si të veprohet ose që të jenë një komision i përzier që t'i hartojnë rregullat.

Ardian Gjini- Ishte i mendimit se duhet të kërkohet nga departamenti ligjor i Kuvendit të bëjë një interpretim ligjor të këtyre dispozitave, sepse kemi shërbime profesionale. Po me duket që edhe sot kemi dilema lidhur me këtë çështje, duke shtuar se kryesia ka marrë vendim me të cilin e ka ngarkuar Komisionin për Legjislacion, por nëse është e nevojshme duhet t'i kthehet kryesisë, nëse kemi dilema

ligjore se cili komision duhet t'i hartojë rregullat. Këtë dilemë nuk mund ta zgjedhin dy komisione, këtë dilemë e zgjidh shërbimi ligjor.

Arsim Bajrami- Shprehu mendimin se do të ishte mirë që derisa një çështje shtyhet dhe vendoset përsëri në rend dite, ajo duhet të jetë e kualifikuar për vendimmarrje, jo të kthehemi aty ku ishim para një jave. Ai shtoi se me sqarimin e administratës, unë po besoj që nuk jemi Komision Funkcional, por në anën tjetër hartimi i rregullave të procedurës është punë normative, dhe kjo është kompetencë e Komisionit për Legjislacion.

Kryetari- Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se herën e kaluar, me kërkesën e deputetëve ka mbetur që kjo pikë të shtyhet që të konsultohemi me ligjin për të, pas një opinionimi më të qartë. Në sajë të atyre që u thanë tash, ne mund të jemi kompetent për hartimin e rregullave, por jo kompetent për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Prandaj mendoj që zgjedhja më e mirë do të ishte që t'i kërkojmë me shkrim, ose një arsyetim kryesisë lidhur me këtë çështje.

Ibrahim Makolli- Në fjalën e tij të serishme tha se jemi katër ose pesë anëtarë që kemi marrë pjesë në hartimin e ligjit për Avokatin e Popullit dhe tjetër është çka është menduar dhe tjetër është çka është shkruar gjatë hartimit të këtij ligji. U pajtua me z. Bajrami që nuk ka asnjë komision më kompetent për t'i hartuar këto rregulla se sa Komisioni për Legjislacion.

Kryetari propozoi që të formohet grupi i punës, i cili do të fillojë me hartimin e rregullave dhe në këtë grup mund ta përfshihet, një anëtar nga komunitetet, Ibrahim Makolli dhe Armend Zemaj, pasi që kanë qenë edhe anëtarë në hartimin e ligjit, si dhe Arsim Bajrami.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, nxori këtë:*

PËRFUNDIM

Formohet Grupi i punës për hartimin e rregullave të procedurës për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, në këtë përbërje:

*Arsim Bajrami – kryesues,
Armend Zemaj – anëtar,
Ibrahim Makolli – anëtar,
Jasmina Zhivkoviç- anëtare.*

4. Shqyrtimi i Përfundimit të Kryesisë lidhur me kërkesën e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Kryetari – I njoftoi me përfundimin e kryesisë lidhur me kërkesën e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, që Adem Vokshi të riemërohet për anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Prandaj lidhur me këtë propozim pyeti, a ka ndonjë dilemë?

Ibrahim Makolli- Në fjalën e tij tha se për mua nuk ka dilema, ngase edhe herën e kaluar ka qenë i njëjti dhe i plotëson kushtet ligjore. Mirëpo, pasi është mandati i ri i Kuvendit, ka deputetë të tjerë që nuk e dinë se a i plotëson kushtet ligjore, pasi kandidati nuk e ka sjellë dosjen e tij të plotë. Prandaj propozoj që të kërkohet nga Gjykata Supreme të sjellë dosjen e plotë për kandidatin.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, nxori këtë:*

PËRFUNDIM

Komisioni për Legjislacion kërkon nga Gjykata Supreme e Kosovës që ta plotësojë dosjen për kandidatin Adem Vokshi, i propozuar për t'u riemëruar për anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

5. Formimi i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit;

Kryetari – Theksoi se tani kemi edhe anëtarin për Nënkomisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren nga G/P i Vetëvendosjes. Konsideroj se formohet nënkomisioni me përbërjen e propozuar nga mbledhjen e kaluar.

***Kryetari** konstatoi se Komisioni për Legjislacion, lidhur me këtë çështje, nxori këtë:*

PËRFUNDIM

I. Formohet Nënkomisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, në këtë përbërje:

- Armend Zemaj (GP- LDK)- kryesues,
- Behar Selimi (GP – PDK)- anëtar,
- Ibrahim Makolli (GP- AKR) - anëtar ,
- Albulena Haxhiu (GP – V.V.) – anëtare,
- Ardian Gjini (G/P - AAK), anëtar,
- Mufera Sinik (G/P 6+) - anëtare,
- Jasmina Zhivković, (G/P – SLS)- anëtare.

II. Ngarkohet nënkomisioni që të ndërmerren veprimet e nevojshme për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në shtojcën II (e dytë), pika 16 e Rregullores së Kuvendit.

6. Të ndryshme.

Albulena Haxhiu- Kërkoj nga administrata që materialet për mbledhje t'i kemi paraprakisht, jo vetëm pasi të vijmë në mbledhje, në mënyrë që të kemi kohë t'i shikojmë, që gjerat t'i kemi të qarta.

Armend Zemaj- Unë kam një propozim për ju, si kryetar, që vendimet që vijnë prej Kryesisë së Kuvendit, paraprakisht të konsultohen, para se të vijnë në Komision, pavarësisht qëndrimit që ne e kemi si anëtarë të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi